

LIGJ
Nr. 145/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, DATË 21.3.1995 “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 75/a bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Fjalët “79 shkronjat c dhe ç” zëvendësohen me fjalët “78/a, 79 shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 79/c”.
- b) Numri 114/b hiqet.

Neni 2

Në nenin 406, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përgjithshëm zëvendësohet me tridhjetë e pesë vjet burgim.”.

Neni 3

Pavarësisht ndryshimeve, sipas nenit 1 të këtij ligji, procedimet penale të filluara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të gjykohen nga gjykata që ka kompetencën lëndore, sipas legjislacionit në fuqi në momentin e kryerjes së veprës penale.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.5.2013

Shpallur me dekretin nr. 8177, datë 14.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani